

Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë

KODI I INTEGRITETIT



Publikuar nga

Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë (ERRU)

Blv. Gjergj Fishta, Nr.10
Tiranë, Shqipëri

E-mail: public@erru.al
Tel.: 00355 4 2258046

Web: www.erru.al

© Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë

Korrik 2012

Mbështetur nga

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

PARATHËNIE

Si pjesë e detyrës sonë në rregullimin e sektorit ujësjellës kanalizime në Shqipëri jemi në bashkëpunim të vazhdueshëm dhe ndërveprim me një numër të gjerë aktorësh, ku secili është ndjek interesat institucionale përkatëse. Ndonjëherë ne përballlemi me vendimmarrje të vështira. Në mënyrë që të përmbushim me sukses detyrat tona institucionale e ligjore, me qëllim që vendimmarrja të jetë e drejtë dhe e bazuar në të mirën e publikut, është thelbësore jo vetëm ruajtja e pavarësisë individuale e institucionale por dhe llogaridhënia jonë ndaj qytetarëve shqiptarë.

Nën drejtimin e një komisioni me përvojë dhe me mbështetjen e një stafi të motivuar, kemi qenë në gjendje që gjatë gjithë këtyre viteve jo vetëm të forcojmë ndjeshëm proceset rregullatore në sektorin ujësjellës kanalizime por dhe të rrisim në mënyrë të konsiderueshme profesionalizmin në punën tonë. Tashmë ne kemi arritur në një pikë në procesin tonë të zhvillimit institucional ku kemi kuptuar se është e rëndësishme të nxjerrim në pah një çështje të veçantë që përbën një element kryesor të ekasitetit dhe qëndrueshmërisë së punës tonë: përkushtimin tonë për të punuar me integritet. Këtë vlerë e ripohon edhe ky Kod Integriteti, i cili, i prezantuar në këtë dokument, do të shërbejë në të njëjtën kohë si udhërrëfyes për brezat e ardhshëm në ERRU.

Njohja e këtij kodi, përbën një detyrim institucional për të gjithë zyrtarët tanë dhe për këdo që do t'i bashkohet institucionit tonë në të ardhmen. Është përkushtimi ynë i brendshëm dhe i jashtëm për të qenë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në Shqipëri, si dhe veçanërisht me ato që kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit, konfliktit të interesit dhe çështjeve të integritetit dhe etikës. Kodi gjithashtu është hartuar në mënyrë të tillë që të pasqyrojnë sfidat që lidhen me punën tonë rregullatore. Së fundmi, ky Kod përbën një kontribut konkret në zbatim të Strategjisë së Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente dhe në drejtim të angazhimit të vendit për të zbatuar Nenin 8 të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC).

KODI I INTEGRITETIT

ENTI RREGULLATOR I UJIT I SHQIPËRISË (ERRU)

I hartuar në përputhje me Ligjin nr. 8102 të datës 28.03.1996 “Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë, dhe të Largimit dhe të Përpunimit të Ujërave të Ndotura” si dhe me ndryshimet e tij përkatëse në fuqi dhe në të ardhmen, me Ligjin Nr. 9131 të datës 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”, Ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005 “Mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit gjatë Ushtrimit të Funksioneve Publike”, Ligjin nr. 8484 datë 12.05.1999 “Mbi Kodin e Procedurës Administrative”, dhe Ligjin nr. 9049 datë 10.04.2003 “Mbi Deklarimin dhe Kontrollin e Aseteve e Detyrimeve Financiare të Zyrtarëve të Zgjedhur dhe disa Nëpunësve Publikë” ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, si edhe me Rregulloret e brendshme përkatëse të ERRU-së.

NENI 1 – QËLLIMI

1.1 Përmes miratimit të këtij Kodi Integriteti, ne përkushtohemi të përmbushim mandatin dhe të përmbushim vizionin/misionin tonë në mënyrë të përgjegjshme dhe të pavarur.

NENI 2 – FUSHA E VEPRIMIT

2.1 Këtij kodi do ti nënshtrohen të gjithë zyrtarët e ERRU-së. Për qëllime të këtij kodi fjala “zyrtarë” do të nënkuptojë si anëtarët e komisionit ashtu edhe stafin.

2.2 Të njëjtit kod, do ti nënshtrohen dhe duhet ta firmosin së bashku me kontratën e tyre edhe personat me të cilët do të lidhen kontrata konsulence.

NENI 3 – PËRGJEGJËSITË

3.1 Përgjegjëse për zbatimin e këtij kodi është hierarkia ekzistuese e ERRU-së.

3.2 Zbatimi i këtij kodi do të mbështetet gjithashtu nga Komiteti i Integritetit. Komiteti i Integritetit do të përbehet nga përfaqësues të Sektorit Juridik dhe Sektorit të Burimeve Njerëzore të propozuar nga Kryetari dhe të miratuar nga Komisioni për një vit.

3.3 Detyrat e komitetit të integritetit janë:

- a. Të këshillojë në lidhje me paqartësitë në përmbajtjen dhe mbi çështje të lidhura me zbatimin e këtij kodi;
- b. Të këshillojë zyrtarët të cilët përballen me situata të cilat nuk parashikohen specifikisht as nga legjislacioni dhe as nga kodi;
- c. Koordinimi i veprimtarive që mundësojnë kuptimin e kodit;
- d. Ti japë Komisionin Kombëtar informacione dhe sugjerime lidhur me ndryshimet e nevojshme në kod;

3.4 Zyrtarët të cilët shkelin kodin, apo rregullat dhe ligjet mbi bazën e të cilave ky kod është ndërtuar, do të sanksionohen në përputhje me standardin e procedurave administrative.

NENI 4 – PARIME TË PËRGJITHSHME

- 4.1** Të gjithë zyrtarëve të ERRU-së ju është besuar një funksion për të vepruar në të mirë të interesit publik. Për këtë arsye, ata do të jenë besnikë interesit të Publikut Shqiptar siç ai është i shprehur përmes institucioneve demokratike të qeverisjes.
- 4.2** Zyrtarët do të kryejnë detyrat dhe funksionet e tyre me integritet dhe profesionalizëm. Ata do të bëjnë të mundur që burimet publike për të cilat ata janë përgjegjës do të administrohen në çdo kohë në mënyrën më efektive dhe eficiente, në mënyrë që përdorimi i tyre, të jetë gjithmonë i justifikueshëm para publikut dhenë përputhje me ushtrimin adekuat të detyrave të tyre profesionale.
- 4.3** Zyrtarët, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre do të jenë të vëmendshëm, të sjellshëm, të drejtë dhe të paanshëm, në veçanti, në marrëdhënien e tyre me publikun. Ata do të kryejnë detyrat e tyre zyrtare në mënyrë të tillë që besimi i publikut tek Enti të rritet.
- 4.4** Zyrtarët nuk do të praktikojnë në asnjë moment trajtim preferencial jo të ligjshëm, përfshirë dhurata apo favore ndaj asnjë lloj grupi apo individ;apo të diskriminojnë një grup ose një individ, ose nga ana tjetër të abuzojnë me pushtetin dhe autoritetin e veshur në ta.
- 4.5** Në të gjithë veprimtarinë e ERRU-së është i ndaluar çdo lloj dallimi mbi bazën e racës, kombësisë, moshës, paaftësisë, gjinisë, gjendjes civile, lidhjeve familjare, origjinës sociale, fesë, orientimit seksual, apo lidhjeve politike.

NENI 5 – PAANSHMËRIA

- 5.1** Zyrtarët do të trajtojnë të gjithë individët dhe organizatat me të cilët ata hyjnë në marrëdhënie me ndershmëri dhe paanshmëri.
- 5.2** Gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, zyrtarët nuk do të:
- Marrin angazhime, japin këshilla jo-zyrtare apo të bëjnë premtime mbi rastet në procedim e sipër për të cilat nuk është marrë akoma një vendim;
 - Marrin pjesë në mbledhje jo-zyrtare në të cilat trajtohen rastet në procedim e sipër mbi të cilat ERRU-ja nuk ka marrë akoma një vendim ose i cili nuk iu është komunikuar akoma palëve të përfshira. Në lidhje me të gjitha mbledhjet e tjera jo-zyrtare ku trajtohen çështje që kanë të bëjnë me punën e tyre, zyrtarët, ose do të kërkojnë autorizimin e Kryetarit, ose, kur kjo nuk është e mundur për arsye objektive, do ta njoftojnë Kryetarin më pas. Në rastin kur është i përfshirë një nga anëtarët e Komisionit Kombëtar, ai/ajo do të informojnë Kryetarin dhe anëtarët e tjerë të Komisionit.
- 5.3** Stafi profesionist do të takohet me personat e përfshirë në çështje në procedim e sipër nga ERRU-ja, përveçse të shoqëruar nga një person i dytë.
- 5.4** Zyrtarët mund të jenë anëtarë të organizatave të ndryshme politike dhe jo politike, por pikëpamjet ose opinionet politike të zyrtarëve do të komunikohen qartësisht si pikëpamja e tyre personale, dhe në asnjë rast si shprehje e funksionit të tyre në ERRU.

NENI 6 – KONFLIKTI I INTERESIT

- 6.1** Zyrtarët nuk do të abuzojnë me funksionin që u është besuar për të përfituar në lidhje me interesat e tyre private ose me ato të familjes dhe miqve të tyre.
- 6.2** Zyrtarët duhet të deklarojnë asetet, bizneset, interesat ose veprimtaritë financiare apo tregtare të ndërmarra për përfitime financiare të cilat mund të sjellin për pasojë konflikt të mundshëm ose potencial interesi, siç edhe parashikohet nga Ligji apo Rregulloret.
- 6.3** Zyrtarët nuk do të përdorin në asnjë moment në mënyrë të papërshtatshme fondet, pronat, apo shërbimet publike ose informacionin e marrë gjatë, ose si rezultat i detyrës së tyre zyrtare për veprimtari që nuk janë të lidhura me punën e tyre zyrtare.
- 6.4** Pas largimit nga pozicionet e tyre zyrtarët nuk do të shfrytëzojnë për keq pozicionin e tyre të mëparshëm brenda ERRU-së.

NENI 7 – DHURATAT DHE FAVORET

- 7.1** Zyrtarët nuk do të kërkojnë ose pranojnë nga të tjerët, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte, as dhurata dhe as favore, qofshin këta individë, biznese apo ente të tjera me të cilin ERRU-ja kryen veprimtari pavarësisht nga lloji.
- 7.2** Zyrtarët të cilët në mënyrë të pavullnetshme pranojnë dhurata ose favore me vlerë domethënëse do të njoftojnë menjëherë me shkrim eprorin e tyre direkt, i cili do të informojë komitetin e integritetit për të marrë masa mbi kthimin e tyre përmes shërbimit administrativ të ERRU-së. Në rastin kur bëhet fjalë për një anëtar të Komisionit Kombëtar, ai/ajo do të njoftojë Komisionin Kombëtar.

NENI 8 – INFORMACIONI DHE KONFIDENCIALITETI

- 8.1** Zyrtarët do të bëjnë të mundur mbrojtjen dhe konfidencialitetin e informacionit të printuar ose elektronik, në përputhje me Ligjet dhe Rregulloret përkatëse në fuqi.
- 8.2** Zyrtarët nuk do të:
- bëjnë të ditura informacione lidhur me veprimtaritë kërkimore, kontrollet ose hetimet që janë në vazhdim e sipër Brenda ERRU-së;
 - bëjnë të ditura informacione ose të shprehin publikisht mendime mbi çështje që janë në procedim e sipër brenda ERRU-së për të cilët nuk është marrë vendim ose që palët e përfshira nuk janë njoftuar ende;
 - përdorin informacionin e fituar në vazhden punës së tyre për përfitime personale.
- 8.3** Këto kufizime do të vazhdojnë të jenë në fuqi dhe pas përfundimit të marrëdhënies kontraktuale me ERRU-në.
- 8.4** Zyrtarët do të vënë në dispozicion informacione, individëve ose organizatave, jashtë apo brenda ERRU-së, të cilët kanë të drejtë për të marrë informacione, në përputhje me Ligjet dhe Rregullat në fuqi. Informacionet që janë të kufizuara nga sekretin profesional, Ligjet apo Rregulloret mbi fshehtësinë në detyrë, nuk do të vihen në dispozicion.

NENI 9 – MARRËDHËNIET ME JASHTË

- 9.1** Zyrtarët nuk do të bëjnë deklarata publike që mund të ndikojnë negativisht në imazhin e ERRU-së.
- 9.2** Nëse Zyrtarët marrin kërkesa nga media për dhënie informacioni apo sqarimesh ata do të informojnë Kryetarin dhe Komisionin Kombëtar. Përveç rastit kur ata kanë mandat nga Kryetari, në asnjë rrethanë ata nuk do të komentojnë, publikojnë, apo bëjnë të ditur në çdo lloj forme, lajme lidhur me veprimtarinë e ERRU-së.
- 9.3** Zyrtarët që propozojnë të publikojnë artikuj apo çështje të tjera dokumentare lidhur me mandatin e ERRU-së do të njoftojnë kryetarin për qëllimet e tyre
- 9.4** I gjithë komunikimi përmes email-it zyrtar me individët apo organizatat e jashtme do të reflektojë profesionalizmin e ERRU-së dhe do të bëhet vetëm përmes adresës zyrtare të email-it të ERRU-së.
- 9.5** Për të gjitha proceset zyrtare të komunikimit me jashtë, zyrtarët duhet që të kenë marrë mandat nga Kryetari. Në rastin e Komisionit Kombëtar, mandati komunikimit vendoset bashkërisht me Kryetarin dhe anëtarët e tjerë të Komisionit.

ligj
kod
besim **etikë**
udhëzues transparencë
rregulla **paanshmëri**
ligj praktikë e drejtë
përgjegjësi **parime**
sjellje **standarte** kod
rregulla të brendshme
vlerat
të pavarur
besim **përforcim**
integritet
ligj përgjegjësi
besim **sjellje** ligj
udhëzues ndershmëri **kod**
konfidencialitet
kod **përgjegjësi**
rregulla të brendshme
koflikt interesi **besim**
respekt
rregulla
kod